



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

*7 maj 2018, Prizren*

**KOMUNIKATË PËR MEDIA  
Publikohet Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale  
për vitin 2017**

EC Ma Ndryshe ka publikuar Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale, në kuadër të cilit janë pasqyruar rezultatet për 13 grupe indikatorësh relevantë që tregojnë nivelin e transparencës gjatë vitit 2017 në komunat e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajit, Pejës, Gjilanit, Gjakovës, Mitrovicës, si dhe Rahovecit, Vushtrrisë, Malishevës, Suharekës, Klinës, Dragashit, Shtërpçës dhe Mamushës.

Në Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale për periudhën e monitorimit janar-dhjetor 2017 figuron se Komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjakovës përbëjnë grupin e parë të komunave transparente me 68 për qind përkatësisht 64 për qind të vlerësimit, pastaj radhiten Gjilani me 56 për qind e Peja me 54 për qind, të pasuara nga Mitrovica me 48 për qind, Prizreni me 42 për qind dhe Ferizaj me 41 për qind. Te komunat që nuk janë qendra rajonale prijnë Rahoveci dhe Vushtrria me 53 përkatësisht 51 për qind, pastaj Malisheva me 46 për qind, Suhareka 43 për qind, Klina 39 për qind, Shtërpca 37 për qind, Dragashi 32 për qind dhe Mamusha me 26 për qind.

Grupet e indikatorëve që janë monitoruar dhe mbi të cilat është shkruar Indeksi janë: Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit, Organizimi dhe funksionimi, Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse, Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve, Integrimi Evropian, Kontabiliteti dhe buxheti, Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve, Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike, Pasuria kapitale dhe jokapitale, Informimi dhe shërbimi i qytetarëve, Bashkëpunimi me shoqërinë civile, Planifikimi urban dhe Monitorimi i projekteve urbanistike. Përmbajtjen e plotë të Indeksit mund ta lexoni në linkun: <http://online-transparency.org/indeksi/>

Krahasuar me rezultatet e vitit 2016, del se 10 komuna gjatë vitit 2017 kanë shënuar rritje të transparencës, megjithëse me përqindje të vogël. Në 2 komuna (Shtërpçë dhe Mamushë) nuk është regjistruar ndonjë përparim, pra përqindja ka mbetur e njëjtë, derisa në 3 komuna (Gjakovë, Ferizaj dhe Klinë) ka pas rënie të përqindjes së transparencës, të shkaktuar kryesisht nga mosfunksionimi i ueb faqes zyrtare (shkaku i problemeve teknike që sipas zyrtarëve komunalë janë përgjegjësi e MAPL-it dhe jo e komunave).

Çështja e mosfunksionimit të kohëpaskohshëm të ueb faqeve zyrtare të Komunave, sidomos në pjesën e fundit të vitit ka paraqitur një sfidë për transparencën e pushtetit lokal. Në të njëjtën kohë, viti 2017 ka qenë sfidues për transparencën edhe shkaku i zgjedhjeve komunale, që ka ndikuar negativisht në këtë aspekt sidomos në pjesën e dytë të vitit.

Marrë në përgjithësi, transparenca në luftimin e keqpërdorimeve, prokurimin publik, menaxhimin e pronës komunale, pastaj në planifikimin urban dhe monitorimin e projekteve urbanistike mbeten sfida të rëndësishme për komunat, të cilat duhet të adresohen nga lidhshipi komunal i dalë prej zgjedhjeve të vjeshtës së vitit të kaluar.

Ndërkohë rezultate më inkurajuese ka në aspektin e transparencës së punës së organeve politikbërëse dhe vendimmarrëse, transparencës buxhetore, pastaj te informimi e shërbimi i qytetarëve dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Megjithëkëtë në komuna të caktuara edhe në këto indikatorë nevojitet angazhim për shtimin e nivelit të transparencës, me qëllim të afrimit të mëtejme të pushtetit lokal me qytetarin.

Një vëzhgim i monitoruesve të Indeksit ka qenë se pas intervistave të zhvilluara me Komunat, në përgjithësi ka pas ecuri pozitive në publikimin e informatave dhe dokumenteve të caktuara, gjë e cila sipas EC-it duhet të vazhdojë së aplikuari në përditshmëri, bashkë me shtimin e sensit të llogaridhënies kundruall publikut nga lidhshipi dhe zyrtarët komunal.

Indeksi është një përpjekjeje e EC-it për të siguruar transparencë më të madhe në nivelin komunal me hulumtimin e hollësishëm të problemeve aktuale rreth transparencës dhe llogaridhënies së komunave, duke dhënë vlerësime apo nota për këto probleme. Indeksi i ofron mbështetje komunave në kuptimin e çështjeve për përmbushjen e standardeve të qeverisjes së mirë dhe shtimit të llogaridhënies përballë publikut.

Projektin “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale”, EC Ma Ndryshe e ka iniciuar nga maji i vitit 2015 dhe i njëjti ka shtrirje në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, pastaj Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë, Shtërpçë, Vushtrri dhe Klinë. Projekti në fjalë ka për qëllim që ti asistoj komunat në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre.

Me respekt,  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771